



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës - Ministry of Infrastructure - Ministerstvo Infrastrukture



**UDHËZIMI ADIMINISTRATIV (MI) NR. 09/2015 PËR KYÇJE, INSTALIME NËPËR TOKËN
RRUGORE DHE PËR SHFRYTËZIM TË TOKËS SË RRUGËVE NACIONALE DHE RAJONALE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MI) NR. 09/2015 FOR CONNECTION, INSTALATIONS
THROUGHT THE ROAD LAND, AND LAND USE OF NATIONAL AND REGIONAL ROADS**

**ADMINISTRATIVNA UREDBA (MI) BR. 09/2015 ZA PRIKLUČENJE, INSTALACIJU PO PUTNOM
ZEMLJIŠTU I ZA KORIŠĆENJE ZEMLJIŠTA NACIONALNIH I REGIONALNIH puteva**

<p>Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 42 dhe 27 Ligjit nr. 2003/11 përrugët (GZ. Nr.16/ 01 Shtator 2007), dhe Ligji nr.03/L-120 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit përrugë Nr.2003/11, (GZ. Nr.46/15 Janar 2009), nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011, Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrat 6 të Rregullores së Punës se Qeverisë Nr. 09/2011, (GZ Nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p>UDHËZIMI ADIMINISTRATIV (MI) NR. 09/2015 PËR KYÇJE, INSTALIME NËPËR TOKËN RRUGORE DHE PËR SHFRYTËZIM TË TOKËS SË RRUGËVE NACIONALE DHE RAJONALE</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzim Administrativ është që të përaktohen kushtet dhe procedurat për dhënien e kushteve të projektimit dhe ndërtimit të: kyçjeve, instalimeve dhe shfrytëzim të tokës në rrugët Nacionale dhe Rajonale.</p>	<p>Minister of Ministry of Infrastructure.</p> <p>Pursuant to Article 42, and 27 of Law no. Roads 2003/11 (OG.No.16/ 01 September 2007), and Law No.03 / L-120 on amending and supplementing the Law on the Roads No.2003/11 (OG.Nr.46/15 January 2009), Article 8, paragraph 1.4 of the Regulation no.02/2011 for the areas of administrative responsibility for the Office of the Prime Minister and Ministries and Article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 (NP No.15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MI) NR. 09/2015 CONNECTIONS, INSTALATION THROUGHT THE ROAD LAND, AND LAND USE OF NATIONAL AND REGIONAL ROADS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is to define the conditions and procedures for design and construction of: connections, installation and use of land in national and regional roads.</p>	<p>Ministarstvo Infrastrukture,</p> <p>Na osnovu člana 42 i 27 Zakona br. 2003/11 za puteve (SL. Br.16/ 01 Septembar 2007), i Zakon br.03/L-120 za izmenu i dopunu Zakona za puteve Br..2003/11,(SL.Br.46/15 Janar 2009), člana 8 stava 1.4 te Uredbe Br. 02/2011 za oblasti administrativne odgovornosti Ureda Premijera i Ministarstava kao i člana 38 stava 6 Poslovnika Vlade Br. 09/2011,(SL Br.15, 12.09.2011),</p> <p>Donosi:</p> <p>ADMINISTRATIVNU UREDBU (MI) BR. 09/2015 ADMINISTRATIVNA UREDBA (MI) BR. 09/2015 ZA PRIKLUČENJE, INSTALACIJA PO PUTNOM ZEMLJIŠTU I ZA KORIŠĆENJE ZEMLJIŠTA NACIONALNIH I REGIONALNIH PUTEVA</p> <p>Član 1 Cilj</p> <p>Cilj ove Administrativne Uredbe je da se utvrde uslovi i procedure za davanje uslova projektovanja i izgradnje: uključivanja, instalacija i korišćenju zemljišta na nacionalnim i regionalnim putevima.</p>
---	--	--



<p>Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ rregullojnë procedurat për dhënien e pëlqimit për kyçje, instalimeve, shfrytëzim të brezit rrugorë, pjesëve të tokës rrugore, dhe kushteve teknike për projektimin dhe ndërtimin e kyçjes në rrugët Nacionale dhe Rajonale.</p>	<p>Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Administrative Instruction regulate the procedures for consent to build the connection, installation, use of the roadside, road land parts, and technical requirements for the design and construction of connections to national and regional roads.</p>	<p>Član 2 Delokrug</p> <p>Odredbe ove Administrativne Uredbe regulišu procedure za davanje saglasnosti za izgradnju uključivanja, instalacija, korišćenju putnog pojasa, delova putnog zemljišta, i tehničkih uslova za projektovanje i izgradnju uključivanja na nacionalnim i regionalnim putevima.</p>
<p>Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Kyçje – nënkupton rrugën e cila lidhet në rrugën Nacionale dhe Rajonale e që përdoret për shfrytëzim individual dhe kolektiv.</p> <p>1.2. Kyçja individuale - nënkupton lidhjen me rrugët Nacionale dhe Rajonale për shfrytëzim individual nga prona dhe ndërtimet individuale jo komerciale.</p> <p>1.3. Kyçja kolektive - nënkupton kyçjen e cila përdoret nga më shumë se</p>	<p>Article 3 Definitions</p> <p>1. Terms used in this Administrative Instruction have the following meanings:</p> <p>2.1. Connection – means the road which connects to the National and Regional road that is used for individual and collective use.</p> <p>1.2. Individual Connection - means the connection with National and Regional roads for individual use of property and individual non-commercial buildings.</p> <p>1.3. Collective connection - means the connection which is used by more than</p>	<p>Član 3 Definicije</p> <p>1. Upotrebljeni izrazi u ovoj Administrativnoj Uredbi imaju ova značenja:</p> <p>2.2. Uključivanje – podrazumeva put koji se povezuje na nacionalnom i regionalnom putu i koji se upotrebljava za individualno i kolektivno korišćenje.</p> <p>1.2. Individualno uključivanje – podrazumeva povezivanje sa nacionalnim i regionalnim putevima sa vlasništvom i individualnu i ne komercijalnu izgradnju.</p> <p>1.3. Kolektivno uključivanje – podrazumeva uključivanje koje se</p>



një shfrytëzues.	one user.	upotrebljava više od jednog korisnika.
1.4. Kyçje gjatësore - paraqet sipërfaqen për skaj rrugëve Nacionale dhe Rajonale në të cilën për shkak të veprimitarive të caktuara ndodh ndalimi i automjeteve dhe në të cilën janë një apo më shume shfrytëzues, të dhënë sipas skicës në shtojcën 1 të Këtij Udhëzimi Administrativ.	1.4. Longitudinal connection - presents the surface on the side of the National and Regional roads that due to certain activities stopping of vehicles occurs and in which there are one or more users, according to the drawing given in Annex 1 of this Administrative Instruction.	1.4. Dužinsko uključivanje – predstavlja površinu blizu ivice nacionalnih i regionalnih puteva na kojem zbog određenih delatnosti dogada se zaustavljanje motornih vozila i na kojoj se nalaze jedan i više korisnika, datih prema skici u prilogu 1 ove Administrativne Uredbe.
1.5. Parashtrues i kërkesës - nënkupton personin fizik apo juridikë, i cili aplikon për të marrë pëlqim për ndërtimin e kyçjes në rrugë Nacionale dhe Rajonale.	1.5. The Applicant - means any natural or legal person who applies in order to receive consent for the construction of connection to national and regional roads.	1.5. Podnositel zahteva – podrazumeva fizičko ili pravno lice, koje aplicira za dobijanje saglasnosti za izgradnju uključivanja na nacionalnim i regionalnim putevima.
1.6. Pëlqim për ndërtimin e kyçjes - nënkupton dokumentin (Vendimin) e lëshuar nga Ministria me të cilën jepet e drejta e për fillimin e ndërtimit të kyçjes në rrugët Nacionale dhe Rajonale.	1.6. Consent for the construction of the connection - means the document (Decision) issued by the Ministry with which is given the right to start the construction of the connection to national and regional roads.	1.6. Saglasnost za izgradnju uključivanje – podrazumeva dokumenat (Odluku) izdatu od Ministarstva sa kojom se daje pravo za početak izgradnje uključivanja na nacionalnim i regionalnim putevima.
1.7. Instalimet në tokën rrugore – nënkupton vendosjen dhe shtrirjen e kabllove të ndryshme nëntokësore, gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit apo instalime tjera.	1.7. Installations on road land – means placing and laying of different underground cables, water and sewage pipes or other installations.	1.7. Instalacije na putnom zemljištu – podrazumeva postavljanje i prostiranje raznih podzemnih kabala ili druge instalacije.
1.8. Sipërfaqja e shfrytëzuar për Kyçje - nënkupton sipërfaqen e tokës	1.8. Surface used for connection - means the land surface area of the road	1.8. Iskorišćena površina za Uključivanje -podrazumeva površinu



<p>së rrugës (brezit rrugorë dhe tokës tjetër rrugore) e cila shfrytëzohet për hyrje dhe dalje të automjeteve në rrugë Nacionale dhe Rajonale.</p>	<p>(roadside and other road land) which is used for entry and exit of vehicles in national and regional roads.</p>	<p>putnog zemljiša (putni pojas i drugo putno zemljište) koje se koristi za ulazak i izlazak motornih vozila na nacionalnim i regionalnim putevima.</p>
<p>1.9. Shfrytëzim i tokës – nënkuption marrjen e tokës në shfrytëzim për kyçje, vendosje të instalimeve, me qira dhe vendosjen objekteve të përkohshme (objekteve montazhë, kioskë, rimorkio, karrocë lëvizëse dhe të ngjashme) për qëllime komerciale.</p>	<p>1.9. Land use – means usage of land on leasing for connection, placement of installations, for rent and placement of temporary buildings (montage facilities, kiosks, trailers, wheeled tariler and similar) for commercial purposes.</p>	<p>1.9. Korišćenje zemljišta – podrazumeva uzimanje zemljišta na korišćenje za uključivanje, postavljanje instalacija, pod zakup i postavljanje privremenih objekata (montažnih objekata, kioski, prikolica, pokretnih kolica i slično) za komercijalne ciljeve.</p>
<p>Neni 4 Pëlqimi për ndërtimin e kyçjes</p>	<p>Article 4 Consent for the construction of the connection</p>	<p>Član 4 Saglasnost za izgradnju uključivanja</p>
<p>Ndërtimi i kyçjes në rrugët Nacionale dhe Rajonale bëhet më dhënen e pëlqimit nga Ministria.</p>	<p>Construction of the connection to the National and Regional roads is done after the consent from the Ministry.</p>	<p>Izgradnja uključivanja na nacionalnim i regionalnim putevima se vrši davanjem saglasnosti od Ministarstva.</p>
<p>Neni 5 Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e pëlqimit për ndërtimin e Kyçjes</p>	<p>Article 5 Required documentation for receiving the consent for the construction of the connection</p>	<p>Član 5 Potrebna dokumentacija za dobijanje saglasnosti za izgradnju Uključivanja</p>
<p>1. Personi juridik apo fizik i cili kërkon pëlçim për ndërtimin e kyçjes në rrugë Nacionale apo Rajonale kërkesën e parashtron në arkivin e Ministrisë.</p>	<p>1. Legal or natural person requesting the consent for the construction of the connection to national or regional roads submits the request to the archives of the Ministry.</p>	<p>1. Pravno ili fizičko lice koje traži saglasnost za izgradnju uključivanja na nacionalnim i regionalnim putevima zahtev podnosi u arhivu Ministarstva.</p>



<p>2. Kërkesës i bashkangjiten dokumentat si vijon:</p> <p>2.1. Formularin për aplikim për ndërtim të kyçes e cila është në shtojcën nr.2 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>2.2. Dëshmia mbi pagesën për kyçje individuale në vlerë prej pesëdhjetë 50 €, ndërsa për kyçje kolektive dhe kyçje gjatësore në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë 150 €.</p> <p>2.3 Projektin për ndërtimin e kyçes (të hartuar nga një kompani e regjistruar ose licensuar për hartim të projekteve), i cili së paku duhet të përbaj:</p> <p>2.3.1 Plani i situacionit për ndërtimin e kyçes në përpjesë 1:500, plani duhet të jetë i punuar në sistemin koordinativ Kosovar.</p> <p>2.3.2 Profili gjatësor i rrugës Nacionale apo Rajonale në përpjesë 1:1000/100.</p> <p>2.3.3 Profili tërthor i rrugës</p>	<p>2. The request must have attached the following documentation:</p> <p>2.1 Application form for construction of the connection which is in Annex No. 2 of this administrative instruction.</p> <p>2.2. Proof of payment for individual connection in the amount of fifty 50 €, while for collective connection and longitudinal connection in the amount of one hundred- and fifty 150 €.</p> <p>2.3. Project design for the construction of the connection (prepared by a company registered or licensed for project design), which should contain at least:</p> <p>2.3.1 Situation plan for the construction of the connections in scale 1:500, the plan should be designed according to Kosovo coordinates system.</p> <p>2.3.2 The longitudinal profile of the national or regional road in scale 1:1000/100.</p> <p>2.3.3 Cross - cutting profile of</p>	<p>2.Zahtevu se prilaže sledeća dokumentacija:</p> <p>2.1 Formular za aplikaciju za izgradnju uključivanja koji je u prilogu br. 2 ove Administrativne Uredbe.</p> <p>2.2. Dokaz o plaćanju za individualno uključivanje u vrednosti od pedeset 50 €, dok za kolektivno uključivanje i dužinsko uključivanje u vrednosti od sto pedeset 150 €.</p> <p>2.3 Projekat za izgradnju uključivanja (izrađen od jedne registrovane ili licencirane kompanije za izradu projekata), koji najmanje treba da sadrži:</p> <p>2.3.1 Plan stанице за изградњу укључивања у размери 1:500, план треба да буде израђен у Косовском координативном систему.</p> <p>2.3.2 Dužinski profil nacionalnog i regionalnog puta у размери 1:1000/100.</p> <p>2.3.3 Unakrsni profil nacionalnog i</p>
--	---	--

Nacionale apo Rajonale në vendin e kyçes, në përpjesë 1:100.	National or Regional road at the place of the connection, in scale 1:100.	regionalnog puta u mestu uključivanja, u razmeri 1:100.
2.3.4 Detajet e skicuara, objektet për largimin e ujërave, lidhjen e trupit të Rrugës si dhe detajet tjera në përpjesë 1:50.	2.3.4 The detailed drawings, facilities for water removal, the connection of the road segment and other details in scale 1:50.	2.3.4 Skicirani detalji, objekti za ostranivanje voda, povezivanje tela Puta i drugi detalji u razmeri 1:50.
2.3.5 Dimensionimin e konstruksionit të rrugës kyçese dhe shiritave plotësuese për hyrje dhe dalje në rrugën Nacionale apo Rajonale.	2.3.5 Construction dimensions of the connection road and additional entry and exit lanes in the National or Regional road.	2.3.5 Dimenzioniranje konstrukcije uključivačkog puta i dopunskih traka za ulazak i izlazak na nacionalnom ili regionalnom putu.
2.3.6 Përshkrimi Teknik.	2.3.6 Technical description.	2.3.6 Tehnički opis.
2.3.7 Projektin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal të kyçes.	2.3.7 Project design for horizontal and vertical signaling of the connection.	2.3.7 Projekat horizontalne i vertikalne signalizacije uključivanja.
2.4 Originali i kopjes së planit dhe fletëspeseduese mbi pronësinë e tokës me një ekstrakt original nga kadastra jo më të vjetër se tre muaj.	2.4 The original copy of the plan and the ownership certificate of the land with an original extract from the cadastre, not older than three months.	2.4 Original kopije plana i posedovni list o vlasništvu zemljišta sa jednim originalnim izvodom iz katastra ne stariji od tri meseca.
2.5 Fotokopjen e letërmjostimit të parashtruesit të kërkesës për marrjen pëlqimit për ndërtimin e kyçes.	2.5 Copy of the ID of the applicant requesting the consent for the construction of the connection.	2.5 Fotokopija lične karte podnosioca zahteva za dobijanje saglasnosti za izgradnju uključivanja.
2.6 Një përshkrim i shkurtër i llojit të biznesit.	2.6 A brief description of the type of business.	2.6 Jedan kratak opis vrste biznisa.

Neni 6 Kushtet e lokacionit	Article 6 Terms for the location	Član 6 Uslovi lokacije
<p>1. Pëlqimi për kyçje në rrugët Nacionale dhe Rajonale ipet për ato lokacione ku është e siguruar një dukshmëri dhe siguri e mjaftueshme gjatë kyçjes.</p> <p>2. Dukshmëria dhe siguria përcaktohet në bazë të projektit për kyçje i cili hartohet konform normave për projektim dhe ndërtim të nyjeve në të njëjtin nivel.</p> <p>3. Përjashtimisht për kyçje nga paragrafi 2 i këtij neni, dukshmëria mund të arrihet përmes masave gjegjëse si pasqyrave konkave dhe masave tjera.</p> <p>4. Kufizimi i shpejtësisë në rrugën Nacionale dhe Rajonale me qëllim të sigurimit të dukshmërisë në vendin e kyçjes nuk është i lejuar.</p>	<p>1. The consent for connection in the National and Regional roads is given for those locations where it is provided an adequate visibility and security when connecting.</p> <p>2. Visibility and security is determined based on the project design for connection which is prepared in conformity with the standards for design and construction of connections on the same level.</p> <p>3. Notwithstanding for connections from paragraph 2 of this Article, the visibility can be achieved through concrete measures such as concave mirrors and other measures.</p> <p>4. Speed limit in the National and Regional road in order to provide visibility into the connection site is not permitted.</p>	<p>1. Saglasnost za uključivanje na nacionalnim i regionalnim putevima se daje za one lokacije gde je obezbedena i dovoljna sigurnost tokom uključivanja.</p> <p>2. Preglednost i sigurnost se utvrduje na osnovu projekta za uključivanje koji se izraduje shodno normi za projektovanje i izgradnju čvorova na istom nivou.</p> <p>3. Izuzetno za uključivanje iz stava 2 ovog člana, preglednost može da se dostigne preko odgovornih mera kako konkavnih pregleda i drugih mera.</p> <p>4. Ograničenje brzine na nacionalnim i regionalnim putevima u cilju bezbednosti preglednosti na mestima uključivanja nije dozvoljeno.</p>
<p>1. Pëlqimi për kyçje në rrugët Nacionale dhe Rajonale nuk mund të lejohet:</p> <p>1.1. Në vendet ku rruga Nacionale ose</p>	<p>1. Consent for connection into national and regional roads shall not be allowed:</p> <p>1.1. In areas where national or regional</p>	<p>1. Saglasnost za uključivanje na nacionalnim i regionalnim putevima ne može da se dozvoli;</p> <p>1.1. Na mestima gde nacionalni ili</p>



<p>Rajonale është në gjërmim në të dy anët (prejashtimi është rastet kur sigurohet dukshmëri dhe siguri e mjaftueshme në rrugë), në afërsi njëqind 100 m prej tuneleve dhe pesëdhjetë 50 m në afërsi të urave.</p>	<p>road is excavated on both sides (notwithstanding when provided sufficient visibility and safety on the road). hundred 100m distance near the tunnels and fifty 50m near the bridges.</p>	<p>regionalni put je u iskopavanju s obe strane (izuzetno u slučajevima kada se obezbeduje preglednost i dovoljna sigurnost na putu), u blizini sto 100 m od tunela i pedeset 50 m u blizini mostova.</p>
<p>1.2. Në lokacionet ku është paraparë ndërtimi i objekteve që janë në funksion të rrugës.</p>	<p>1.2. In locations where it is foreseen the construction of facilities that are in function of the road.</p>	<p>1.2. Na lokacijama gde je predviđena izgradnja objekata koji su u funkciji puta.</p>
<p>1.3. Në distancë jo më të vogël se njëqind e njëzet (120) m. nga kryqëzimi i rrugës Nacionale me rrugën Rajonale dhe kryqëzimi i rrugës Nacionale në nivel të njëjtë me binarët hekurudhorë.</p>	<p>1.3. In the distance not less than one hundred twenty (120) m from the road intersection of National road with the Regional road, and road intersection of National road in the same level with the railways.</p>	<p>1.3. Na udaljenosti ne manjoj od sto dvadeset (120) m. od raskrsnice nacionalnog sa regionalnim putem i ukrštanje nacionalnog puta na istom nivou sa železničkim šinovima.</p>
<p>1.4. Në distancë më të vogël se njëqind e njëzet (120) m. nga kryqëzimi i rrugëve Rajonale, kryqëzimi i rrugës Rajonale në të njëjtin nivel me binarët hekurudhorë.</p>	<p>1.4. In the distance less than one hundred twenty (120) m from the road intersections of Regional Roads, intersection of Regional road on same level with the railways.</p>	<p>1.4. Na udaljenosti manjoj od sto dvadeset (120) m. od raskrsnice regionalnih puteva, ukrštanje regionalnog puta na istom nivo sa šinovima železničkim.</p>
<p>1.5. Në distancë më të vogël se gjashtëdhjetë (60) m. nga kryqëzimi i rrugëve Rajonale me rrugët lokale.</p>	<p>1.5. In the distance less than sixty (60) m from intersections of Regional roads with the local roads.</p>	<p>1.5. Na udaljenosti manjoj od šesdeset (60) m. od raskrsnice regionalnih puteva sa lokalnim putevima.</p>
<p>1.6. Për objektet që janë ndërtuar në brezin mbrojtës të rrugës Nacionale dhe Rajonale.</p>	<p>1.6. For facilities that have been built in the protection wall of the National and Regional road.</p>	<p>1.6. Za objekte koji su izgrađeni na zaštitnom pojasu nacionalnog i regionalnog puta.</p>
<p>1.7. Parashtruesi i kërkësës nuk</p>	<p>1.7. If the applicant does not fulfill the</p>	<p>1.7. Podnositel zahteva ne ispunjava</p>



<p>përbush kushtet dhe procedurat e parapara me këtë Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>conditions and procedures described by this Administrative Instruction.</p>	<p>uslove i procedure predviđene sa ovom Administrativnom Uredbom.</p>
<p>Neni 8 Kyçjet e përbashkëta</p> <p>Në pjesë të caktuar të rrugës Nacionale apo Rajonale ekziston nevoja për ndërtimin e më shumë kyçjeve në distancë të vogël duhet të ndërtohet një rrugë paralele me rrugën Nacionale apo Rajonale dhe për këto objekte të lejohet vetëm një kyçje e përbashkët, kyçja mund të ndërtohet edhe si një kryqëzimi i ri në rrugën nacionale ose rajonale. Në këtë rast duhet dhënë një arsyetim i veçantë nga parashtruesi i kërkesës.</p>	<p>Article 8 Collective connections</p> <p>In a certain part of the national or regional road there is a need to build more connections in small distance, there should be built a parallel road with the National or Regional road and for these facilities is allowed only one collective connection, the connection can be built as a new intersection in regional or national road. In this case, specific justification should be submitted by the applicant.</p>	<p>Član 8 Zajednička uključivanja</p> <p>Na odredenim delovima nacionalnog ili regionalnog puta postoji potreba izgradnje više uključivanja na manjoj udaljenosti treba da se izgradi jedan paralelan put sa nacionalnim ili regionalnim putem i za oba objekta da se dozvoli samo jedno zajedničko uključivanje, uključivanje može da se izgradi još jedna nova raskrsnica na nacionalnom ili regionalnom putu. U ovom slučaju treba dati jedno posebno obrazloženje od podnosioca zahteva.</p>
<p>Neni 9 Kushtet teknike dhe të sigurisë</p> <p>1. Shiriti për qarkullimin i rrugës kyçëse në vendin e lidhjes me rrugën Nacionale apo Rajonale duhet të ketë gjerësi të njëjtë me shiritin për qarkullim të rrugës Nacionale apo Rajonale.</p> <p>2. Lidhja e skajeve të rrugës lidhëse në vendin e kyçjes në rrugën Nacionale apo Rajonale duhet të bëhet me një hark me rreze $R_{min} = 10\text{ m}$.</p>	<p>Article 9 Technical and safety conditions</p> <p>1. The lane for circulation on connection road in the place of the connection with National or Regional road must have the same width as the circulation lane of National or Regional road.</p> <p>2. Linkage of road edges at the connection place of National or Regional road should be done with a span with radius R of min = 10 m.</p>	<p>Član 9 Tehnički i bezbednosni uslovi</p> <p>1. Traka za promet uključivačkog puta na mestu povezivanja sa nacionalnim ili regionalnim putem treba da ima istu širinu sa trakom za promet nacionalnog ili regionalnog puta.</p> <p>2. Povezivanje ivica puta na mestu uključivanja na nacionalnom ili regionalnom putu treba da izvrši jednim lukom sa jednim poluprečnikom sa R_{min}</p>



<p>Neni 10 Shqyrtimi i kërkesës</p> <p>Kërkesa për kyçje në rrugët Nacionale dhe Rajonale, e dorëzuar përmes arhivës së MI-së shqyrtohet në Ministrinë e Infrastrukturës nga zyrtari përgjegjës (i cili duhet të jetë inxhinier i ndërtimtarisë, komunikacionit apo i ngajshëm) i caktuar me vendim të Sekretart të Përgjithshëm. Nëse zyrtari përgjegjës ka nevoj përkushtime specifike profesionale shtesë përkizazi me shqyrtimin e projektit ose komplet kërkesës për kyçje, mund të kërkoj sqarime nga secili zyrtarë i Ministrisë e në veqanti nga Departamenti i Infrastrukturës Rrugore dhe nga Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve (të cilët janë të obliguar ti përgjigjen).</p>	<p>Article 10 Review of the application</p> <p>Request for connection to the national and regional roads, submitted through the Archive of Ministry of Infrastructure is reviewed by the responsible officer of the Ministry of Infrastructure (which should be a construction, traffic engineer or similar) which is designated by decision of the Secretary-General. If the official in charge requests additional professional consultations related to the review of the project or for the entire request for the connection, he may request from each of Ministry officials, especially by of the Department for Road Infrastructure and from Road Management Department (they are obliged to respond).</p>	<p>= 10 m.</p> <p>Član 10 Razmatrane zahteva</p> <p>Zahtev za uključivanje na nacionalne i regionalne puteve, predat preko arhiva MI-re razmatra se u Ministarstvu Infrastrukture od odgovornog zvaničnika (koji treba da bude građevinski inženjer, saobraćaja ili slično) određen odlukom Stalnog Sekretara. Ukoliko odgovorni zvaničnik ima potrebe za stručno dodatno konsultovanje vezano sa razmatranjem projekta ili komplet zahtevom za uključivanje, može da traži objašnjenja svaki od dužnosnika ministarstva posebno od zvaničnika Departmana Putne Infrastrukture i od Departmana Menadžiranja puteva (koji su obavezni da odgovaraju).</p>
<p>Neni 11 Vendimi mbi aprovinin apo refuzimin e ndërtimit e kyçjes në rrugë</p> <p>1. Zyrtari përgjegjës për dhënen e pëlqimit për ndërtimin e kyçjes shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e pranuar (i njëjtë mund edhe të kërkoj plotësimin e dokumentacionit nëse konstaton se nuk është i kompletuar brenda 8 ditëve të</p>	<p>Article 11 The decision on the approval or rejection for the construction of connection to the road</p> <p>1. The responsible officer for granting the consent for the construction of the connection reviews the application and the documents received (the same could also request completion of documentation, if he concludes that the documentations are not</p>	<p>Član 11 Odluka o usvajanju ili odbijanju izgradnje uključivanja na putevima</p> <p>1. Odgovorni zvaničnik za izdavanje saglasnosti za izgradnju uključivanja razmatra zahtev i primljenu dokumentaciju (isti može i da zatraži dopunu dokumentacije ukoliko konsatuje da nije kompletirana u roku od 8 radnih</p>



<p>punës). Zyrtari përgjegjës i rekomandon Sekreatrit të Përgjithshëm në afat prej tridhjet (30) ditë për aprovim apo refuzim të kërkesës, i cili nxjerr vendim për lejimin apo mos lejimin e ndërtimit të kyçës.</p>	<p>complete, within 8 working days. The responsible officer recommends to the Secretary General within thirty (30) days for approval or rejection of the request, and issues a decision on allowing or rejecting the construction of the connection.</p>	<p>dana. Odgovorni zvaničnik preporučuje Stalnom Sekretaru u roku od trideset (30) dana za usvajanje ili odbijanje zahteva, koji donosi odluku za odobravanje ili ne odobravanje uključivanja.</p>
<p>Neni 12 Afat për paraqitjen e ankesës</p>	<p>Article 12 Deadline for submitting an appeal</p>	<p>Član 12 Rok za podnošenje zahteva</p>
<p>1. Kundër vendimit për refuzimin ndërtimit të kyçës, pala mund të parashtroj ankesë në arkivin e Ministrisë në afat prej tridhjet (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.</p> <p>2. Kundër vendimit refuzues të ankesës pala mund të fillojë kontestin në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.</p>	<p>1. Against the decision for rejection of the construction of the connection, a party may submit an appeal in the archives of the Ministry within thirty (30) days after receiving the decision.</p> <p>2. Against the decision for rejecting the appeal, the party may initiate dispute process in a competent court within thirty (30) days after receiving the decision.</p>	<p>1. Protiv odluke za odbijanje izgradnje uključivanja, stranka može da podnese zahtev u arhivu Ministarstva u roku od trideset (30) dana od dana prijema odluke.</p> <p>2. Protiv odbijuće odluke može da pokrene spor u nadležnom sudu u roku od trideset (30) dana od dana prijema odluke.</p>
<p>Neni 13 Ndërtimi i kyçës</p>	<p>Article 13 Construction of the connections</p>	<p>Član 13 Izgradnja uključivanja</p>
<p>1. Ndërtimi i kyçës në rrugën Nacionale apo Rajonale fillon pas marrjes së pëlqimit për ndërtimin e kyçës.</p> <p>2. Ndërtuesi i kyçës gjatë procesit të ndërtimit duhet të ndërmerr të gjitha masat të cilat sigurojn qarkullim të sigurt në</p>	<p>1. Construction of the connection to national or regional road begins upon receiving the consent for construction of the connection.</p> <p>2. Constructor of the connection during the construction process should take all the measures which provide secure and safe</p>	<p>1. Izgradnja uključivanja na nacionalnim ili regionalnim putevima počinje nakon dobijanja saglansosti za izgradnju uključivanja.</p> <p>2. Graditelj uključivanja tokom procesa izgradnje treba da preduzima sve mera koje obezbeduju siguran promet u</p>

komunikacionin rrugor, tē mos ketē ndikimin negativ nē ambient dhe tē mos ketē dëmtim tē rrugëve.	circulation of road traffic, without any negative impact on the environment and any damage to the roads.	drumskom saobraćaju, da ne bude negativnog uticaja na sredinu i da nema oštećenja puteva.
3. Konstruksioni i rrugës kyçëse, duhet tē jetë i konstruksionit tē njëjtë me atë tē rrugës nē tē cilën kyçet.	3. The construction of the connection to the road, should be similar to the road construction to which is getting connected.	3. Konstrukcija uključivačkog puta, treba da bude iste konstrukcije s onim putem na koji se uključuje.
4. Për kyçje tē objekteve tē banimit me karakter tē shfrytëzimit individual kyçja mund tē lejohet tē ndërtohet me konstruksion më tē dobët se konstruksioni i rrugës Nacionale apo Rajonale.	4. For connection of residential buildings with the purpose for individual use, may be allowed the connection to be constructed with lower quality of construction than the construction of National or Regional road.	4. Za uključivanje objekata za stanovanje od karaktera individualnog korišćenja uključivanje može da se dozvoli da se izgradi slabijom konstrukcijom od konstrukcije nacionalnog ili regionalnog puta.
5. Kyçja nē rrugën nationale apo rajonale duhet tē ndërtohet nē atë mënyrë, që tē mos e dëmtojë regjimin ekzistues tē largimit tē ujërave sipërsaqësore dhe nëntokësore. Largimi i ujërave sipërsaqësor duhet tē bëhet me kanalin përgjatë tërë vijës pér kyçje nē rrugë nē një distancë jo më tē vogël se një (1)m nga vija e skajshme e shtresës qarkulluese.	5. Connection into national or regional road must be constructed in a way that does not damage the removal of the existing regime of surface and underground waters. Removal of surface water should be done with the channel across the whole line for connection to the road at a distance of not less than one (1) m from the extreme line of circulating layer.	5. Uključivanje na nacionalnom ili regionalnom putu treba da se izradi tako, da ne šteti postojeći režim ostranivanja površinskih i podzemnih voda. Ostranivanje površinskih voda treba da se izvrši kanalom tokom cele linije za uključivanje na putevima na jednoj ne manjoj od jednog (1) m od krajnje linije prometnog sloja.
6. Në zonat urbane ku kalojnë rrugët Nacionale apo Rajonale kyçja duhet tē jetë edhe nē harmoni me planet urbanistike tē komunave përkatëse.	6. In urban areas where national or regional roads come across ,the connection also shall be in accordance with the urban plans of relevant municipalities.	6. U urbanim zonama gde prolaze nacionalni ili regionalni putevima uključivanje treba da bude i u saglasnosti sa urbanističkim planovima odgovarajućih opština.
7. Nëse poseduesi i pëlçimit nuk fillon	7. If the holder of consent no begins to	7. Ako se nositelj pristanak priključka se



<p>ndërtimin e kyçjes në afatin prej 2 vite nga dita e marrjes së pëlçimit, konsiderohet se ka hequr dor nga kyça dhe pëlçimi shfuqizohet me automatizëm. e njëjtë vlen edhe përvendosjen e instalimeve.</p>	<p>build connection within 2 years from receipt of consent considered to have given up the connection and consent repealed automatically, the same applies to the placement of installations.</p>	<p>ne početí izgradnja u roku od dvije godine od dana zaprimanja pristanak, smatra se da je odrekao priključak i automatski ukinuti ukinuo, isto vrijedi i za uspostave instalacija.</p>
<p>Neni 14 Mbikëqyrja e punimeve gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtja</p>	<p>Article 14 Supervision of works during construction and maintenance</p>	<p>Član 14 Nadgledanje radova tokom izgradnje i održavanje</p>
<p>1. Mbikëqyrja punimeve gjatë ndërtimit të kyçjes në rrugë bëhet nga inxhinieri apo kompania e regjistruar ose e licensuar (e ndryshme nga kompania e cila e ka hartuar projektin) i/e emruar dhe kontraktuar nga parashtruesi i kërkesës.</p> <p>2. Mirëmbajtjen pë�manentë të kyçjes dhe sanitimet e dëmtimeve eventuale në rrugë bëhen nga personi juridik apo fizik që ndërton kyçjen.</p>	<p>1. Supervision of works during construction of the connection to the road is made by the engineer, registered or licensed company (other than the company that has prepared the project design) appointed and contracted by the applicant.</p> <p>2. Permanent maintenance of the connection and possible damage repairs in the road are carried out by a natural or legal person that builds the connection.</p>	<p>1. Nagledanje radova tokom izgradnje uključivanja na putevima se vrši od inženjera ili kompanije registrovane ili licencirane (različite od kompanije koja je izradila projekat) imenovan/na ugovoren/a od podnosioca zahteva.</p> <p>2. Permanento održavanje uključivanja i saniranja eventualnih šteta na putevima se vrše od pravna ili fizička lica koji izgrađuju uključivanje.</p>
